

# A janë hoxhallarët të pakritikueshëm?

## Description

Përgatiti: Rezart Beka

Shpesh tek myslimanët shohim një qëndrim sipas së cilit çdokush i cili guxon të kritikojë, këshillojë, hoxhallarët në publik konsiderohet si fitnaxhi, i infiltruar nga ndonjë grup i caktuar etj. Kryesisht ndaj këtyre njerëzve derdhet gjithë armiqësia dhe përçmimi i myslimanëve. Ata etiketohen si njerëz të prishur si dhe shpesh këshillohen të tjerët që të mos qëndrojnë me ta dhe të mos ia dëgjojnë fjalën atyre.

Ky qëndrim është bërë më i theksuar kohët e fundit, dhe shtrirja e tij nuk kufizohet më vetëm tek imamllarët “e drejtë”, por një qëndrim i tillë këshillohet të mbahet edhe ndaj të gjithë njerëzve me pozita drejtuese në bashkësinë myslimane.

Në fakt, ky fenomen është i ri në historinë tonë të shkurtër, për arsye se vetëm para pak kohësh, një qëndrim si ai që përmenda më lart, kufizohej vetëm ndaj atyre që merrnin guximin të ndërmerrenin ndonjë veprim publik, këshille apo parandalimi nga e keqja, ndaj hoxhallarëve që shiheshin si në rrugë të drejtë, ndërsa për të tjerët lumi i akuzave nuk ndalej madje edhe nga vetë liderët fetarë.

A është një qëndrim i tillë i justifikueshëm fetarisht? A mundet një individ që dëshmon një të keqe, sipas mendimit dhe bindjes së tij, të kritikojë, këshillojë, t’u tërheqë vëmendjen publikisht liderëve fetarë? A duhen konsideruar këta njerëz si fitnaxhi apo si njerëz të cilët përipiqen të dërgojnë deri në fund një amanet të madh të Zotit, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Pra, sipas mendimit tim, çështja fetarisht shtrohet: A ka të drejtën, në Islam, një njeri të formojë një opinion dhe ta shprehë atë qoftë edhe publikisht? A përfshin kjo e drejtë edhe lirinë për të qortuar dhe kritikuar liderët fetarë dhe administrativë? Nëse po, nga buron e drejta për një veprim të tillë?

Do të mundohemi shkurtimisht dhe brenda mundësive të parashtrijmë atë që mendojmë se është qëndrimi i vërtetë Islam në lidhje me këtë çështje. Këtë do ta bëjmë duke u mbështetur pothuajse tërësisht në veprat e Muhamed Hashim Kemalit i cili i ka dedikuar një hapësirë të veçantë kësaj teme në librat e tij. Duhet pasur parasysh se fokusi i artikullit është shqyrtimi i ekzistencës apo jo të të drejtës fetare të besimtarëve të thjesht për të kritikuar qoftë edhe publikisht autoritetet fetare, por nuk duhet harruar që kjo e drejtë duhet shoqëruar edhe me disa norma fetaro-etike të të sjellurit dhe të adresuarit në publik.

### 1. Hisbah si burim i lirisë së shprehjes në Islam

Hisbah njihet ndryshe si parimi i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja (el-amr bil maruf ve uel-nehj en el-munker). Dijetarët myslimanë e kanë konsideruar këtë parim si “shtylla e fesë” (el-kutb el-

adham fi-din)<sup>[1]</sup> dhe kanë pohuar se neglizhimi i saj sjell shkatërrimin për ymetin mysliman. Po ashtu edhe Ibn Kajim el-Xhevzijeh shprehej se hisbah ishte një nga parimet qendrore të qeverisjes Islame dhe një farz kifaje ku çdokush duhet të marrë pjesë sipas mundësive të tij<sup>[2]</sup>. Në trajtesat klasike të fikhut Islam hisbah shihet si një *obligim* që, nëse kryhet nga një grup, bie përgjegjësia mbi pjesën tjetër. Allahu (xh.sh.) në një ajet kuranor shprehet: “*Nga ju le të jetë (ualtakun) një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit (muflihun)*“. (Kuran 3:104; shih edhe 3:110 dhe 22:41)

Imam Gazaliu ka vërejtur se, meqenëse ky verset fillon me një urdhërim (le të jetë, *ualtakun*), ai përçon një obligim (*vaxhib*), që do të thotë, se ai është një obligim i përbashkët i të gjithë bashkësisë. Natyra kolektive e këtij obligimi përcaktohet gjithashtu në të njëjtin tekst, veçanërisht kur thuhet: “le të jetë ‘*një grup*’”, duke nënkuptuar se obligimi përmbushet edhe nëse vetëm një pjesë e vogël e bashkësisë e plotëson atë. Përmbushja e hisbas, siç pohohet edhe në ajet, është shkak i suksesit (*felah*) në këtë botë dhe botën tjetër<sup>[3]</sup>. Gjithsesi, siç shprehet edhe usulisti Hashim Kemali, “...më e mira do të ishte që e gjithë bashkësia ta zbatonte hisbën”<sup>[4]</sup>.

Nuk mund të lemë pa përmendur edhe hadithin profetik i cili flet për hisbën: “*Cilido prej jush që sheh një vepër të keqe, duhet ta ndreqë atë me duart e tij, nëse nuk ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e tij, e nëse as kjo nuk i mundësohet, atëherë (le ta denoncojë) me zemër, por ky është besimi më i dobët*“

Shtjellimi i mëtejshëm i mënyrës se si kuptohet këto etapa etj, nuk janë objekt i bisedës sonë, për këtë arsye nuk do ti shtjellojmë. Por ajo që duhet përmendur është fakti se ndonëse hisbah është një farz kifaje ajo gjithsesi bëhet obligim për individin që dëshmon në një ngjarje që, sipas bindjes së tij, është e keqe. Ajo është obligim (*vaxhib*) kur individi dëshmon në kryerjen e një vepre që konsiderohet haram dhe është e pëlqyeshme (*mendub*) nëse individi dëshmon në kryerjen e nje vepre të papëlqyeshme (*mekruh*)<sup>[5]</sup>.

## Hisbah dhe liria e shprehjes

Hisbah është një nga burimet e rëndësishme të lirisë së shprehjes në Islam, kjo për arsye se mungesa e lirisë së shprehjes minon së brendshmi vetë strukturën e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Në “deklaratën universale të drejtave të njeriut në Islam”, një publikim ky i Këshillit Islam të Evropës, ky dokument i referohet hisbës njëkohësisht si një “e drejtë dhe detyrë e çdokujt” për të folur dhe mbrojtur të drejtat e të tjerëve si dhe të bashkësisë kur ato kërcënohen apo shkelen<sup>[6]</sup>. Kjo gjë mbështetet edhe nga A. J. Hammad, i cili vëren se “*hisbah, duke qenë një nga shtyllat e besimit dhe principi kryesor i sheriatit, na pajis me mbështetjen e duhur që do të mjaftonte edhe vetvetiu për ta bërë të vlefshme lirinë e shprehjes në çështjet politike dhe qeverisëse*”<sup>[7]</sup>. Zejdani tregohet më i ndjeshëm kur pohon se një kuptim dhe zbatim i saktë i “*principit të hisbës e bën të nevojshme lirinë e individit për të formuluar dhe shprehur një opinion*”<sup>[8]</sup>. Për Mustafa Sibain, qëllimi kryesor i hisbës është mirëqenia e shoqërisë, për arsye se hisbah ngre themelet e asaj që ai e ka quajtur shoqëri (el-hurrijat el-ixhtimaije). “*Hisbah u akordon atyre që janë të aftë ta mbajnë atë, lirinë për të formuar një opinion, lirinë për ta shprehur këtë opinion, madje edhe lirinë për të kritikuar të tjerët për çështje që kanë lidhje me probleme sociale*”. Sibai shton se “*nëse ndokush është i pranishëm gjatë kryerjes së një veprë të keqe që kundërshton sheriatin, apo që kundërshton standardet e sjelljes së hijshme si dhe standardet e normave të pranuar nga shoqëria, për atë individ bëhet e detyrueshme që, brenda mundësive të tij/asaj, ta ndalojë këtë veprim*”<sup>[9]</sup>.

## **E drejta për ta kryer publikisht urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja**

Hashim Kemali ka parashtruar shtjellimin klasik të mënyrës dhe shkallëve në bazë të së cilave zbatohet hisbah.

Ai shprehet: “Ekzistojnë katër shkallë të hisbës, të cilat gjithashtu specifikojnë, për nga mënyra se si janë dhënë, rendin e saktë të prioritetit që duhet ndjekur gjatë përpjekjes për ta zbatuar atë. Këto janë: e para, njoftimi, (*ta’rif*) qoftë verbalisht apo me shkrim, i personit që është duke kryer veprën, në lidhje me ligësinë e këtij veprimi. Nëse kjo tregohet e pamjaftueshme atëherë duhet vazhduar me fazën e dytë – këshillim i ngrohtë (*vaz*), për të ngjallur drojën ndaj Zotit dhe për ti bërë thirrje mendjes dhe ndjenjës së sinqertë. Nëse edhe kjo nuk jep frytet e saj, atëherë faza e tretë lejon edhe përdorimin e *fjalëve të ashpra*. Kjo mund të përfshijë edhe kërcënim, por nuk duhet të jenë në formë akuze apo fyerje. Fjalë dhe shprehje që përbëjnë denoncim mund të jenë të tilla si: “o zullumqar” (*ja dhalim*); ose “o injorant” (*ja xhahil*); apo “a nuk ke droje Zotin?”<sup>[10]</sup>. Imam Gazaliu pohon se përdorimi i forcës duhet kryer vetëm atëherë kur ajo bëhet e pashmangshme dhe me qëllim që të ndalojë të keqen. Gjithsesi me të nuk duhet synuar dënimi i fajtorit por vetëm ndalimin e të keqes. P.sh. ai përmend raste si, të thyesh instrumentet e kumarit, të derdhësh verën etj. <sup>11</sup>

Dijetarët myslimanë kanë thënë se ekzistojnë disa kategori ndaj të cilëve nuk zbatohet faza e katërt, siç janë p.sh. babai, burri dhe kryetari i shtetit. Kjo për arsye të mos shkaktimit të fitnes. Gjithsesi siç shprehet edhe dijetari i njohur hanbeli Ibn Kudame el-Makdesi, fjalët e ashpra mund të përdoren edhe ndaj imamit nëse kjo shihet se është e nevojshme, madje në disa raste ajo është edhe e preferueshme (mendua). Shumica e dijetarëve e lejojnë përdorimin e fjalëve të ashpra edhe në ato raste ku mendohet se nëse do të shkaktohet ndonjë fitne ajo do të prekë vetëm personin ndaj të cilit janë ndërmarrë këto hapa. Nëse shihet se fitnja e shkaktuar do të jetë më e madhe se dobia atëherë hisbah nuk duhet zbatuar. [12]

## Përfundime

Nga ky shtjellim i shkurtër i parimit të hisbës kuptuam se çdo myslimani që dëshmon në një ngjarje e cila, sipas bindjes së tij, përbën të keqe apo haram i garantohet liria që të formulojë një mendim qortues dhe ta shprehë si privatisht ashtu edhe publikisht. Madje edhe duke përdorur fjalë të ashpra apo forcë.

Një tjetër element i rëndësishëm është që sipas Islamit personi i cili zbaton parimin e hisbës nuk duhet dyshuar si keqdashës për sa kohë nuk ka prova të qarta dhe të prera (kat) të cilat dëshmojnë këtë opsion. Kjo sepse, siç do të shohim më vonë, bazuar në parimet e usul fikut të quajtura Asl e Sihah dhe Istishab një njeri konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij. Ndjeka e dyshimeve, hamendësimeve, apo epshit i cili të shtyn të shohësh në një kritikë gjithnjë të keqen është *haram* në Islam. Siç thotë edhe Allahu (xh.sh.) në Kuran: “*O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve (dhan) të shumta, meqë disa dyshime (dhan) janë mëkat.*” (Kuran 49:12).

### 1. Këshilla e sinqertë si burim i lirisë së shprehjes në Islam

Një tjetër institucion shumë i rëndësishëm në Islam është edhe dhënia e këshillës së sinqertë (nasih). Në aspektin gjuhësor kjo fjalë (nasih) do të thotë: “këshillë e sinqertë”, ‘këshillë miqësore’ dhe ‘përkujtim miqësor’<sup>[13]</sup>. Nasihah shihet si një pjesë e rëndësishme e fesë e cila i kërkon besimtarëve që të jenë gjithnjë vigjilentë në ruajtjen e normave morale, shpirtërore dhe njerëzore. Të angazhohen sinqerisht dhe energjikisht në kryerjen e tyre dhe në nxitjen e të tjerëve për ta bërë këtë. Sipas dijetarëve myslimanë ajo ka të njëjtin status me parimin e hisbës, pra është farz kifaje (obligim kolektiv). Ajo është e ngjashme me hisbën, por dallon në një tipar. Ndërsa hisbah përqendrohet në urdhërimin për të mirë dhe në ndalimin nga e keqja, nasihah (këshilla) përqendrohet më shumë në urdhërimin për të mirë se sa në ndalimin nga e keqja.

Njësoj si hisbah edhe nasihah (këshillah) konsiderohet si pjesë integrale e fesë. Përshembull, raportohet se njëherë profeti (s.a.v.s.) i ka thënë shokëve të tij ‘feja është këshillë’, pohim i cili tërhoqi me vete menjëherë pyetjen ‘ndaj kujt [i përket kjo e drejtë dhe detyrë] o i dërguari i Zotit?’ Kësaj profeti iu përgjigj ‘ndaj Zotit, librit të tij, të dërguarit të tij, liderëve dhe njerëzve të thjesht të bashkësisë’<sup>[14]</sup> Ndërsa komentonte këtë hadith, imam Neveviu, autori i Rijadu Salihinit, citon Hatabin të ketë thënë se

shprehja 'feja është këshillë' (ed-din e nasih) d.m.th. se ajo është mbështetëse dhe rrjedhimisht shtyllë e fesë (kiuam el-din ue imaduhu). Përshembull, kur thuhet 'Arafati është vetë haxhi' (el-Haxh el-Arafah), kjo nënkupton se Arafati është shtylla, një *sine qua non* e haxhit<sup>[15]</sup>.

## Nasihah dhe liria e shprehjes

Këshilla e sinqertë, njësoj si hisbah, është po ashtu një burimi për lirinë e shprehjes në Islam. Kjo për arsye se nëse mungon liria e shprehjes nasihah është i perealizueshëm në jetën e përditshme, në këtë mënyrë kërcënohet të neglizhohet një pjesë e rëndësishme e fesë. Nasihah është e lidhur ngushtë me besimin dhe nuk mund të bëjë pa të. Në një hadith të transmetuar nga Xhabir bin Abdullah-i pohohet: “*Shkova tek profeti (s.a.v.s.) dhe deklarova “Zotohem para teje se pranoj Islamin (ubejjuke alel-Islam)”.* Profeti (s.a.v.s.) tha: “*me kusht që ti japësh këshilla të sinqerta njerëzve*”... *kështu unë e dhashë dhe vendosa këtë garanci në betimin tim për besnikëri*”<sup>[16]</sup>.

Hashim Kemali shprehet: “*Në këtë mënyrë, nasihah e merr për të mirëqenë të drejtën e çdo individi për të formuar një opinion apo këshillë në të cilën ai/ajo sheh dobishmëri, si dhe të drejtën për t’ia përcjellë në fshehtësi atë të tjerëve, qoftë ky një qytetar i thjesht apo një lider qeveritar*”<sup>[17]</sup>.  
. Për më tepër, opinioni apo këshilla mund të jepet për çështje sociale, politike apo personale, por, siç vëren edhe Hammadi, liria e shprehjes në çështjet politike (hurrijet el-rey el-sijasi) është një prej karakteristikave dalluese të nasihah<sup>[18]</sup>.

## E drejta për ta shprehur publikisht nasihan

Çdokush që sheh një situatë ku mendon se këshilla e sinqertë do të bënte dobi duhet ta zbatojë atë pa hezitim. Pa u frikësuar nga llafet e të tjerëve dhe as nga frika se mos humbet nga një veprim i tillë. Profeti në një hadith shumë të rëndësishëm ka thënë: “Le të mos e poshtëroj askush prej jush veten”. Shokët e tij pasi dëgjuan këtë thanë: “Si mundet dikush ta bëjë këtë (të poshtëroj veten) o i dërguar i Zotit”? Profeti (a.s) iu përgjigj: “Nëse dikush sheh ndonjë rast në të cilin ai duhet të flasë për hir të Zotit, por nuk e bën këtë; Zoti i Lartmadhëruar do ti thotë atij në Ditën e Gjykimit: “Ç’farë të ndaloi ty nga e folura në lidhje me atë çështje?” Kur personi do ti përgjigjet se ai kishte pasur “frikë nga njerëzit”, atëherë Ai do ti thotë: “Do të kishte qenë me drejtë që ti të më ishe frikësuar Mua”<sup>19</sup>“

Kryesisht këshilla jepet veçmas siç thuhet edhe në një hadith të profetit, veçanërisht në lidhje me këshillimin e liderëve: “kur dikush dëshiron ti jap një këshillë (nasih) një personi me autoritet, le të mos e deklaroj publikisht por le ta marrë prej dore e ti flasë atij në fshehtësi. Nëse ajo pranohet, qëllimi është përmbushur, nëse jo dhënësi i këshillës, përsëri, ka kryer detyrën e tij<sup>20</sup>. Megjithkëtë, siç shprehet edhe Hashim Kemali, janë hedhur sugjerime se precedentët e lënë nga sahabët (shokët e profetit), veçanërisht ato të halifëve të drejtë (Hulefai Rashidin), tregojnë se anëtarët e bashkësisë (umetit), burra, gra, lider, kanë dhënë dhe kanë marrë këshilla në një atmosferë jozyrtare dhe publikisht në xhami, në rrugë dhe në prani të të tjerëve. Këto precedentë ofrojnë mbështetje për përfundimin se nuk ka asnjë arsye për të krijuar procedura të veçanta për dhënien e këshillave të sinqerta (nasih)<sup>21</sup>

## Përfundime

Nga ajo që shqyrtoam deri më tani, shohim se liria për tu shprehur është një kusht themelor për ekzistencën e nasihatit. Po ashtu ndonëse në formën e saj më të zakonshme këshilla jepet në mënyrë të posaçme dhe jo publikisht

## Liria për të kritikuar (Hurrijetu el-Muaredah)

Sheriati i ka garantur të drejtën çdo individit që të monitorojë punën e liderëve dhe të kritikojë vendimet dhe veprimet e tyre, përmes këshillës së mirë, kritikizmit konstruktiv etj, saherë që ai sheh se kryhet një veprim i gabuar, i padrejtë apo i paligjshëm. Kjo në Islam njihet ndryshe si hurrijet el-muaradah ose hurrijet el-nakd el-hakim. Ky parim është rrjedhojë dhe pjesë përbërëse e parimit të urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e keqja. Meqenëse muaredah është një rrjedhojë e parimit të hisbës të gjitha argumentet që legjitimojnë hisbën janë të vlefshme edhe për muaredan<sup>[22]</sup>. El-Afifi pohon se ky parim i jep të drejtën individit për të thënë të vërtetën dhe për të treguar të keqen edhe kur kjo nënkupton kundërshtimin e autoriteteve udhëheqëse<sup>[23]</sup>. Po ashtu edhe Muhamd Hidr el-Husein pohon se islami e ka bërë këtë parim ‘një obligim për bashkësinë’ për të monitoruar sjelljen e kryetarit të shtetit dhe vartësve të tij me qëllimin për të ndrequr ata të cilët devijojnë, dhe për ti paralajmëruar ata të cilët mund të neglizhojnë detyrat që i janë ngarkuar<sup>24</sup>.

Por duhet pasur parasysh, siç shprehet edhe Hashim Kemali, që liria për të kritikuar të mos përdoret si mjet për të shkaktuar përçarje dhe turbullirë, apo për përfitime karriere. Në përdorimin e saj legjitim, kjo liri duhet të shërbejë si një dritë për të gjetur të vërtetën, e për të kërkuar për veprimin e drejtë në mënyrë që e gjithë bashkësia të nxjerrë dobi prej saj. Së fundmi, myslimanët janë veçanërisht të udhëzuar në Kuran dhe në traditën profetike për të shmangur kënaqësinë në dyshim dhe hamendësim<sup>25</sup>.

## Disa prej argumenteve për lirinë për të kritikuar publikisht liderët

Siç e thashë edhe më parë të gjitha evidencat kuranore të cilat mbështesnin parimin e hisbës mund të përdoren shumë mirë edhe për hurrijetu el-Muaredah.

Ndërsa në traditën profetike dhe në shembullin e lënë nga të parët tanë të mirë (Selefu Salihin) shembujt bëhen më të qartë dhe më domethënës.

Ibn Hishami në një nga veprat e tij<sup>[26]</sup> raporton se, në vazhden e traktatit të hudejbijes me kurejshët e Mekës, Umer ibn Hatab, ishte kritik ndaj disa klauzolave të traktatit të cilat ai mendonte se ishin të pafavorshme për myslimanët. Umeri u konsultua me Ebu Bekrin në lidhje me këtë çështje, por nuk u kënaq dhe shkoi për ti rrëfyer këndvështrimin e tij ashpërsisht kritik profetit duke i thënë: “A nuk je ti i dërguari i Allahut? Profeti iu përgjigj: “Po unë jam!” “Atëherë përse ne po denigrohemi për shkak të fesë sonë” – pyeti Umeri. Profeti iu përgjigj: “Unë jam shërbëtori dhe i dërguari i Allahut, unë nuk tregoj mosbindje ndaj Tij dhe Ai nuk do më lërë mua të jem prej humbësve”.

Kalifët e drejtë e kërkonin nga njerëzit kritikën, ato e shihnin atë si një begati të dhënë nga Allahu në mënyrë që të mos binin në haram dhe të shpëtonin nga kryerja e veprave të ndaluara. Ky qëndrim është shumë i rëndësishëm të vërehet sot, ku duket se një qasje e tillë është harruar. Për këtë do të na mjaftojnë shembujt e dy njerëzve besnik, e dy sahabëve të shquar, e dy halifëve të drejtë, Ebu Bekrit dhe Umerit.

Transmetohet se Ebu Bekri në fjalimin e tij të parë si kalife i myslimanëve i shpalosi popullit vizionin e tij për qeverisjen, e ndër të tjera i nxiti ata që të monitorojnë punën e qeverisë dhe nëse shihnin ndonjë të metë të bënin kritikën e duhura. Ndër të tjera ai u tha atyre: *“O njerëz jam ngarkuar me autoritet mbi ju, por unë nuk jam më i miri prej jush. Më ndihmoni nëse jam me të drejtën dhe më korrigjoni nëse gaboj”*<sup>[27]</sup>. Hashim Kemali në lidhje me këtë fjalim shprehet: “Ky fjalim konsiderohet gjerësisht si një nxitje drejt kritikizmit konstruktiv ndaj qeverisë, dhe për të nxitur njerëzit që të qendrojnë vigjilent mbi aktivitetet e liderëve të tyre politik”<sup>[28]</sup>, ndërsa për El-Habibin qëndrimi i shfaqur nga Ebu Bekri në fjalimin e tij, tregon se vetkriticismi është jo vetëm dobipurës për zhvillimin, por është gjithashtu edhe tipari i nevojshëm i një qeverisje të përgjegjshme<sup>[29]</sup>.

Në të njetën frymë me paraardhësin e tij edhe Umer Ibn Hatabi mbajti një fjalim hapës të kalifatit të tij të ngjashëm me atë të Ebu Bekrit. Umeri i pyeti njerëzit, gjatë fjalimit të tij të parë, për të korrigjuar çdo lajthitje që ata mund të shihnin në të. Njeri nga dëgjuesit iu drejtua Umerit duke thënë: “Nëse ne shohim tek ty ndonjë devijim, ne do ta ndreqim atë me shpatat tona”. Pasi dëgjoji këtë, kalifi lavdëroi Zotin që ekzistonte një njeri që në rast të një shkeljeje do ta ndreqte atë veprim të gabuar<sup>[30]</sup>.

Një tjetër raportim ka lidhje me çështjen e prikës (mehr). Gjatë një fjalimi publik, kalifi i paralajmëroi njerëzit për shumën e ekzagjeruar që jepej për mehr. Gjithsesi një grua, Fatima bin Kajs, nuk ishte dakord me këtë dhe citoi në mbështetje të mendimit të saj tekstin kuranor IV:20, ndaj të cilës Umeri u përgjigj: “Gruaja ka të drejtë ndërsa Umeri gaboi”<sup>[31]</sup>.

Sipas një tjetër transmetimi, një burrë erdhi tek Umeri dhe iu drejtua atij në mënyrë të vrazhdë duke i thënë: “Ki frikë Zotin, o Umer”. Një i pranishëm i përkujtoi atij se po kalonte kufijtë e hijshmërisë për nga mënyra se si po i drejtohej kalifit, por Umeri iu përgjigj duke thënë: “Nuk do të ishte e mirë sikur ata (njerëzit) të mos na tërhiqnin vërejtjen dhe nuk do të ishte mirë sikur ne mos ti dëgjonin ata”<sup>[32]</sup>.

. Këto ishin disa raste të cilat tregojnë gatishmërinë dhe pëlqimin e selefëve për të mirëpritur kritikën

konstruktive.

## Liria e shprehjes dhe Muaredah

Sipas vlerësimit të Mustafa Sibait, këta precedentë tregojnë qartë se brezi i parë e ka njohur të drejtën e njerëzve për të kritikuar udhëheqësit qeveritarë<sup>[33]</sup>. Sipas Halilit, liria e shprehjes së mendimit që përjetuan myslimanët në fazat e para të historisë është me të vërtetë një model i paarritshëm dhe i patejkaluar nga brezat e mëvonshëm<sup>[34]</sup>. Ebu Habib në një nga veprat e tij pohon se mbi bazën e këtyre precedentëve mund të pohojmë se *'Islami i jep të drejtën qytetarëve për të monitoruar aktivitetet e kryetarit të shtetit dhe qeveritarëve në lidhje me gjithçka që bëjnë dhe që nuk bëjnë'*<sup>[35]</sup>. Muhamd Hidr el-Husein është ende më i ndjeshëm kur pohon se islami e ka bërë këtë parim 'një obligim për bashkësinë' për të monitoruar sjelljen e kryetarit të shtetit dhe vartësve të tij me qëllimin për të ndrequr ata të cilët devijojnë, dhe për ti paralajmëruar ata të cilët mund të neglizhojnë detyrat që i janë ngarkuar<sup>[36]</sup>.

Liria e shprehjes është ngushtësisht e lidhur me mirëfunksionimin e muaredas. Nëse nuk ekziston liria e shprehjes parimi i muaredas është i pamundur të zbatohet<sup>37</sup>.

E drejta për të kritikuar nuk nënkupton të drejtën për të kritikuar për hirë të kritikimit dhe sa që kjo të shndërrohet në një profesion<sup>[38]</sup>.

## Përfundim

Siç e pamë edhe nga ky shqyrtim i shkurtër, në Islam individët janë të nxitur që të monitorojnë punën e qeverisë apo të liderëve të tyre dhe nëse hasin në një veprim apo fenomen i cili duket se është në kundërshtim me normat Islame apo shihet si një gabim me pasoja të rënda për shoqërinë, ato kanë të drejtën që të zhvillojnë kritikizmin e duhur, qoftë privatisht ashtu edhe publikisht, për ti dhënë fund gjendjes së krijuar.

Shkruar në vitin 2009

## Referenca

[1] Gazali. 'Ihja ulumu din' (el-Mektebeh el-Tixharije edn.) II, fq. 310

[2] Ibn Kajim el-Xhevziye, 'Turuk el-Hukmije fil-Sijase el-Sheriah, (El-Muassasah el-Arabije, 1961 edn.) fq. 278.

[3] Gazali, 'Ihja', (el-Mektebeh el-Tixharije edn.), II, 304



- [4] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33
- [5] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33
- [6] Azzam, ed. 'Iniversal Islamic Declaration of Human Rights', fq. 8
- [7] Hammad, 'Hurriyah', fq 221
- [8] Zejdan, 'Mexhmuat Buhuth Fikhije' fq. 128
- [9] Mustafa Sibai, 'Ishtirakijat el-Islam', fq. 52
- [10] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33
- [11] Gazali. 'Ihja ulumu din' (el-Mektebeh el-Tixharijeh edn.) II, fq. 329-333
- [12] El-Makdisi, 'el-Adab', I, fq. 328
- [13] Hans Ęehr, 'Arabic-English Dictionary', fq. 970
- [14] Buhariu, 'Sahih', Kitab el-iman, I, fq. 23; Muslimi, 'Sahih Muslim', Kita bel-Iman, Bab ed-Din el-Nasihah. Ibn Maxheh e citon kĕtĕ hadith dhe e pĕrmend klauzolĕn e parĕ tre herĕ, ndĕrsa Nesaiu e citon klauzolĕn e parĕ me njĕ variant tĕ vogĕl, qĕ ĕshtĕ inema ed-din en-nasih (me tĕ vĕrtetĕ feja ĕshtĕ kĕshillĕ)
- [15] Imam Neveviu, 'Rijadu Salihin', fq. 113, hadithi nr. 186
- [16] Imam Neveviu, 'Rijadu Salihin', fq. 113, hadithi nr. 187
- [17] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33
- [18] Krahaso Hammad, Hurriyeh, fq. 207
- [19] Ibn Maxheh, 'Sunen ibn Maxheh', Kita bel-Fitan, Babe l-Amr bil ma'aruf ve nahijen el munker
- [20] Imam Neveviu, 'Rijadu Salihin', fq. 103-107
- [21] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33; shih edhe Krahaso Ebu Habib, 'Diraseh fi Menhexh el-Islam el-Sijase, fq. 337
- [22] El-Kasimi, Nidham el-Hukm fil Sheriah vel-Tarikh, f. 101
- [23] Afifi, El-Muxhtema el-Islami ve Usul el-Hukm, f. 93; shih gjithashtu edhe Mustafa Sibai Ishtirakijeh, f. 50
- [24] Hysein, Nakd Kitab el-Islam ve Usul el-Hukm, f. 89.
- [25] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33

- [26] Ibn Hisham, Sirah Nebevijeh, III, 331
- [27] Ibn Hisham, el-Sirah, IV, 262; Ebu Habib, Darasah, 725; El-Kasimi, Nidham el-Hukm, f. 106
- [28] Hashim Kemali, 'Freedom of Expression in Islam', Islamic Texts Society, 1995, f. 28-33
- [29] Ebu Habin, Diraseh, f. 727
- [30] Ebu Zehra, el-Xharima vel-Ukubah fil Fikh el-Islami, f. 160; El-Sibai, Ishtirakije, f. 50; el-nahban, Nidham el-Hukm, f. 250.
- [31] El-Khudari, Muhadarat fil Tarik el-Umam el-Islamijeh, II, 17-18; El-Nahban, Nidham el-Hukm, f. 240; Ebu Habib, Deraseh, f. 743
- [32] Ebu Jusuf, Kitab el-Haraxh, f. 13
- [33] Mustafa Sibai Mustafa Sibai, 'Ishtirakijat el-Islam', fq.50
- [34] Khalil, Fil-Nakd el-Islami el-Muasir, f. 35
- [35] Ebu Habib, Diraseh, f. 743
- [36] Hysein, Nakd Kitab el-Islam ve Usul el-Hukm, f. 89
- [37] El-Kasimi, Nidham el-Hukm fil Sheriah vel-Tarikh, f. 100
- [38] Muhamed Sadik el-Afifi, El-Muxhtema el-Islami ve Usul el-Hukm, f. 94

**Date Created**

19/07/2015

**Author**

erasmusi